



Njohja e diplomave

Diplomat e jashtëvendore dhe përfundimet shkollore nuk janë çdoherë në Zvicër të vlefshme. Sipas rrethanave është e mundëshme, që diplomat të procedohen për njohje. Për disa profesione kjo kërkohet detyrimisht patjetër.

Njohja

Personat me diplomë të huaj munden ta procedojnë njohjen në Zvicër me disa kushte. Me njohje vërtetohet, që diploma e huaj, apo një tjetër përfundim i shkollës është njësoj i vlefshëm me diplomën apo përfundimin shkollor të Zvicrës. Te profesionet me kualifikim (p.sh njerëzit për përkujdesje mjekësore, personat mësimor etj.) njohja është e nevojshme, për me mund me e ushtruar profesionin. Për njohje janë sipas profesionit apo arsimimit zyrtar kontaktuese të ndryshme përgjegjëse. Njohja kushton. Për pyetje të përgjithëshme për njohjen e diplomave të huaja është sekretariati i shtetit për arsim, hulumtim dhe inovacion (Staatssekretariat für Bildung, Forschung und Innovation SBF | Secrétaire d'État à la formation, à la recherche et à l'innovation SEFRI) përgjegjës.

Vërtetim mbi nivelin e arsimimit

Te profesionet që mund të ushtrohen pa kualifikim, nuk është e nevojshme njohja e diplomës apo e përfundimeve tjera shkollore për me punue në Zvicër. Për këto profesione mundet me u bë kërkesa për një vërtetim nivelin arsimor (Niveaubestätigung | Attestation de confirmation de niveau). Kjo tregon vlerësimin e diplomës të huaj me atë të sistemit arsimor në Zvicër. Ky vërtetim mund të ndihmoj gjatë kërimit të një vendi pune. Informacione për vërtetim nivelin arsimor e bëjnë vendet kontaktuese nacionale për njohje të diplomave (Nationale Kontaktstelle für Diplomanerkennung | Point de Contact national pour la reconnaissance de diplômes), apo këshillimoret për profesione- dhe qendrat informative (Berufsberatungs- und Informationszentren BIZ | Centres d'orientation professionnelle OP).



Përmbyllja e një profesioni

Të rriturit me përvojë në një profesion, mirëpo pa diplomë të njohur apo pa njohje të përfundimeve tjera shkollore, mundën ta përsërisin shkollimin për të arritur një përfundim shkollor zviceran: arsimim bazë profesional apo arsimim profesionl të lartë. Ecuria mvaret prej arsimimit të mëhershëm, prej përvojës në profesion dhe moshës. Në çdo rast është njohja e gjuhës gjermane si parakusht (niveli B1/B2 sipas GER). Të interesuarit mundën p.sh te këshillimorja për profesione- dhe qendrat informative BIZ (BIZ | OP) të informohen dhe të këshillohen falas. Kush e përsërit dhe e bënë përmbylljen e një profesioni, i përmirëson gjatat e veta në tregun e punës dhe ka çasje në arsimim e mëtutjeshëm.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/njohja-e-diplomave